

20575
28.12.15

8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 12906 (31010-06921-86-2015) Rregj.Them.
Data Regjistrimi 16.11.2015

Nr. 2667 (86-2015-498) Vendimi
Datë 10.12.2015

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA
GJYQTAR - Altina NASUFI
GJYQTAR - Rilinda SELIMI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot me datë 10.12.2015, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë :

PADITËS: Shoqëria "Kromallari" sh.p.k me seli në Fshatin Verdovë, Pogradec.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë.

Me pjesmarjen e Avokaturës Shtetit Zyra Vendore Tiranë.

OBJEKTI: Shfuqizimin e njoftim vlerësimit tatimor nr. 22273 Prot datë 05.12.2014 për gjobën në vlerën 1.500.000 lekë.

BAZA LIGJORE: Nenet 115, 118 të K.Pr. Administrative, ligji nr. 7928, datë 24.04.1995, i ndryshuar, ligji nr. 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008 i Ministrit të Financave.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendimin nr. 459 datë 25.09.2015 ka vendosur :

1. "Rrezimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.
2. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse".

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ka paraqitur ankim pala paditëse shoqëria tregtare "Kromollari" sh.p.k duke parashtruar se:

1. Puntorët për të cilët është marrë akti administrativ objekt gjykimi kanë qënë të kontraktuar nga paditësi për të kryer shërbim për 2-3 orë me qëllim saldimin e një makinerie. Aktiviteti i shoqërisë nuk ka lidhje me shërbimin që po ofronin tre personat e

gjetur në ambientet e shoqërisë. Shoqëria Kromallari shpk ishte në një marrëdhënie juridiko civile që i takon kontratës së sipërmarrjes midis saj si porositore dhe tre personat të cilët ishin në pozitën e sipërmarrësit.

2. Nga ana e inspektorëve të I.SH.P.SH.SH në asnjë moment nuk është lënë të kuptohet se se po mbahet një konstatim i cili pasqyron faktin se shoqëria kishte të punësuar tre punonjës të padeklaruar, përkundrazi kanë marrë kontakt me tre personat, me administratorin dhe janë larguar nga ambienti i shoqërisë sikur çdo gjë ishte konform rregullave.
3. Administrata tatimore nuk ka respektuar te drejtën e palës paditëse që të dëgjohet me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë çka është detyrim i palës së paditur.
4. Gjykata ka gabuar në arsyetimin e saj se kërkesë padia është e pambështetur në ligj dhe në prova. Në bazë të nenit 40 pika 3 të ligjit 49/2012 kur vlerëson se veprimi administrativ apo akti është i ligjshëm dhe i themeltë. Në kushtet kur Gjykata argumenton se akti është absolutisht i pavlefshëm duhet të vendoste në dispozitiv konstatimin e pavlefshmërisë dhe jo të rrëzonte padinë.
5. Akti objekt gjykimi është relativisht i pavlefshëm dhe si i tillë duhet të shfuqizohet pasi neni 116 pika "c" të K.Pr.Administrative veç morespektimit të procedurës kërkon dhe mungesën e formës që të jemi para pavlefshmërisë absolute.
6. Mosrespektimi i procedurës dhe mosmbajtja e procesverbalit konform detyrimeve ligjore i ka cënuar palës paditëse të drejtën për tu dëgjuar dhe për të provuar se personat për të cilët është dënua me gjobë nuk janë punonjës të shoqërisë. Duke qënë para shkeljes së procedurës dhe para një fakti i cili nuk paraqitet si shkelje e detyrimeve ligjore të palës paditëse pretendojmë se jemi përpara pavlefshmërisë relative.

Sa sipër pala e paditëse kërkon ndryshimin e vendimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe pranimin e kërkesë padisë sipas objektit të saj.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë me kërkesë padi duke kërkuar:

Shfuqizimin e njoftim vlerësimit tatimor nr. 22273 Prot datë 05.12.2014 për gjobën në vlerën 1.500.000 lekë

Pala paditëse në lidhje me këto kërtime i ka referuar si bazë ligjore në nenet 115, 118 të K.Pr. Administrative, ligji nr. 7928, datë 24.04.1995, i ndryshuar, ligji nr. 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008 i Ministrisë së Financave.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me vendimin nr. 459, datë 25.09.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së palës paditëse.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala e paditëse shoqëria "Kromollari" shpk për shkaqet e përshkruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala paditëse është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tij, e për rrjedhojë, është shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimin. Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 459, datë 25.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë rezulton se:

Paditësi "Kromallari" shpk është person juridik privat që e ushtron vepimtarinë e saj tregtare në fushën e prodhimit dhe tregtimit të gurëve e nënprodukteve të tij në Qafë-Thanë, sipas ekstraktit të QKR-së.

Nga Inspektorët e Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Dega Rajonale e Qarkut Elbasan është kryer inspektim në datën 29.08.2015 në aktivitetin tregtar të palës paditëse "Kromallari" shpk. Rezulton se ky inspektim është kryer në bazë të autorizimit nr. 0007646, datë 29.08.2014 të Kryeinspektorit. Gjatë inspektimit të kryer nga inspektorët kanë konstatuar 6 persona të punësuar të cilët tre prej tyre ishin të padeklaruar nga organi tatimor dhe të pasiguruar, fakte këto që i kanë dokumentuar në procesverbalin e inspektimit nr. 033425, datë 29.08.2014. Me vendimin përfundimtar nr.0015980, datë 15.09.2014 ka vendosur paralajmërimin për dënim me gjobë për palën paditëse, duke i lënë dhe detyra për të zbatuar brenda një periudhe kohore të caktuar. ISHPSHSH Dega Elbasan i ka dërguar DRT Korçë listën e punëmarrësve të padeklaruar sipas procesverbalit të inspektimit nr. 033425. Bazuar në kërkesën e DRT Korçë, ISHPSHSH Dega Elbasan i ka dërguar kësaj të fundit të gjithë praktikën e inspektimit.

Bazuar në këto dokumenta DRT Korçë ka nxjerrë aktin administrativ – Njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 22278, datë 05.12.2014.

Me aktin administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 22278 Prot. Datë 05.12.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë subjekti "Kromollari" shpk detyrohet të paguajë gjobë për sigurimet shoqërore në vlerën 1.500.000 lekë.

Ndaj këtij Njoftim vlerësimit për detyrimet Tatimore (gjobë) pala kërkuese i është drejtuar me ankim Drejtorisë së Apelit Tatimor (DAT) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. DAT pasi ka shqyrtuar ankimin e palës paditëse dhe dokumentacionin në lidhje me procesin administrativ me vendimin nr. 33696/3 datë 14.04.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor ka vendosur :

"Lënie në fuqi të aktit administrativ, Njoftim Vlerësimit për Detyrimet nr. 22273 Prot. datë 05.12.2014, për gjobë në shumën 1,500,000 lekë nxjerrë nga DRT Korçë" me argumentimin se: dënimi i dhënë nga DRT Korçë për shkeljen tatimore të konstatuar është i bazuar në ligj.

Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar në datën 12.05.2015 Gjykatës së Administrative të Shkallës së Parë Korçë me kërkesë padinë mbi objekt, palë të paditura dhe bazë ligjore siç përshkruhet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendimin nr. 459, datë 25.09.2015 ka vendosur rrëzimin e padisë së shoqërisë tregtare "Kromollari" sh.p.k.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 459 të datës 25.09.2015 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Korçë rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

1. Gjykata çmon se në bazë të nenit 37 të ligjit 9920/2008 pala e paditur ka detyrimin për të respektuar të drejtën për tu dëgjuar të palës paditëse para çdo vendimarrje administrative të administratës tatimore. Në këto rrethana pala e paditur kishte detyrimin të dëgjonte palën paditëse para nxjerrjes së aktit administrativ objekt gjykimi.
2. Nuk rezulton që pala e paditur ta ketë dëgjuar palën paditëse përpara nxjerrjes së njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore. Kjo shkelje procedurale e palës së paditur në nxjerrjen e aktit administrativ ndikojnë në vlefshmërinë e këtij akti administrativ dhe kjo është arsyeja pse ky akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 116/c të K.Pr.Administrative.
3. Në kushtet kur ky akt është absolutisht i pavlefshëm, gjykata nuk mund ta shfuqizojë atë si një akt administrativ relativisht të pavlefshëm, por vetëm mund të konstatojë pavlefshmërinë absolute të tij në pjesën përshkruese arsyetuese të këtij vendimi dhe në përfundim ti japë zgjidhje çështjes lidhur me kërkimet e paditësit në padi.
4. Pretendimet dhe kërkimet për pavlefshmëri absolute të këtij akti administrativ pala paditëse mund ti parashtrojë në një padi që ka këtë kërkim dhe shkak ligjor në bazë të ligjit 49/2012.
5. Kërkimet e paditësit në padi për pavlefshmëri relative të këtij akti administrativ dhe për shfuqizimin e tij janë pretendime të pabazuara në ligj sepse aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk mund të shfuqizohen nga gjykata, pasi janë nul që në momentin e nxjerrjes së tyre.

Gjykata Administrative e Apelit e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të parashtrimeve të paraqitura përpara Gjykatës Administrative të Apelit nga palët ndërgjyqëse, të akteve të administruara pjesë e dosjes së gjykimit, si dhe të vendimit objekt ankimi, Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr. 459, datë 25.09.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në përputhje me ligjin dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi, por me argumentim ndryshe.

Së pari: Pala paditëse në ankimin e saj ka pretenduar se punëtorët për të cilët është marrë akti administrativ objekt gjykimi kanë qënë të kontraktuar nga pala paditëse për të kryer shërbim për 2-3 orë me qëllim saldimin e një makinerie. Aktiviteti i shoqërisë nuk ka lidhje me shërbimin që po ofronin tre personat e gjetur në ambientet e shoqërisë. Shoqëria Kromallari shpk ishte në një marrëdhënie juridiko civile që i takon kontratës së sipërmarrjes midis saj si porositëse dhe tre personat të cilët ishin në pozitën e sipërmarrësit. Gjykata Administrative e Apelit çmon se ky pretendim është i pabazuar në ligj e në prova dhe si i tillë është i papranueshëm. Pala paditëse nuk arriti të provojë përpara gjykatës ekzistencën e një kontrate

sipërmarrje ndërmjet tre personave – punëtorë të padeklaruar dhe shoqërisë “Kromollari” sh.p.k. Gjithashtu ky qëndim është kontradiktor me qëndrimin që pala e paditur ka mbajtur në përmbajtjen e kërkesë padisë në të cilën ka parashtruar se: “Tre personat janë afruar nga ana ime për kryerjen e një saldimi dhe vetëm një prej tyre ka qenë saldator, ndërsa dy personat e tjerë kanë qenë rastësisht duke kullotur bagëtitë në atë vend dhe janë thirrur prej saldatorit meqenëse ai i njihte...”.

Ndërsa nga procesverbali i inspektimit të datës 29.08.2014 rezulton e provuar se pranë këtij subjekti janë konstatuar 6 punëmarrës nga të cilët 3 punëmarrës informal. Për pasojë pretendimi i palës paditëse se këta 3 persona nuk janë punëmarrës informalë, por persona të kontraktuar prej tij është një pretendim i pabazuar në ligj e në prova.

Së dyti: Gjykata Administrative e Apelit çmon se pala e paditur ka vepruar në përputhje me ligjin nr. 9920/2008 neni 119 duke caktuar dënimin administrativ me gjobë për palën paditëse në masën 1.500.000 lekë për tre punonjës të padeklaruar në organet tatimore, bazuar në informacionin e dërguar nga ISHPSSH Dega Elbasan. Ligji nr. 9920/2008 njeh të drejtën e administratës tatimore të marrë dhe të përdorë informacion nga institucione të tjera të administratës publike. Në rastin konkret DRT Korçë bazuar në një akt me vlerë të plotë provuese siç është prosverbali i inspektimit të ISHPSSH-së i datës 29.08.2014 ka dënuar me “gjobë” palën paditëse për shkeljen e parashikuar nga neni 119 “Mosdeklarimi i punonjësve” i ligjit nr. 9920/2008. Kundër këtij njoftim vlerësimi të DRT Korçë shoqëria “Kromollari” shpk ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë DAT Tiranë.

Gjykata e Shkallës së Parë ka gabuar në arsyetimin e saj në lidhje me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë rezulton të ketë arsyetuar: *“...Nuk rezulton që pala e paditur ta ketë dëgjuar palën paditëse përpara nxjerrjes së njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore. Kjo shkelje procedurale e palës së paditur në nxjerrjen e aktit administrativ ndikon në vlefshmërinë e këtij akti administrativ dhe kjo është arsyeja pse ky akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 116/c të K.Pr.Administrative, por gjykata nuk mund të shprehet pasi nuk është kërkuar nga pala”.*

Gjykata Administrative e Apelit, çmon se ky qëndrim i gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar në ligj. Gjykata ka kompetencë të konstatojë pavlefshmërinë absolute në gjykim edhe kryesisht, referuar përcaktimeve të nenit 116 të K.Pr.Administrative si dhe dispozitave të ligjit nr. 49/2012. Qëndron në natyrën e aktit absolutisht të pavlefshëm që të mos sjellë asnjë pasojë juridike e për rrjedhojë ky nuk përbën një akt të anulueshëm apo të shfuqizueshëm pasi është një akt “nul”. Për këtë shkak ligji i ka njohur të drejtën gjykatës që thjesht ta konstatojë nulitetin.

Por në rastin konkret, nuk rezulton të jemi në kushtet e një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm e për rrjedhojë padia duhej të rrëzohej për shkak se është e pathemeltë.

Faktet e parashtruara nga pala paditëse rezultojnë të jenë të pabazuara në prova dhe në ligj në rastin konkret.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se: DRT Korçë ka vepruar në bazë të ligjit duke marrë informacion zyrtar dhe praktikën e shkeljes së evidentuar nga ana e ISHPSSH-së që përbëjnë akte zyrtare me fuqi të plotë provuese, pasi nuk rezulton e provuar gajtë gjykimit se aktet e ISHPSSH-së janë kundërshtuar nga pala paditëse.

Rezulton se DAT Tiranë ka kryer një hetim administrativ të faktit dhe të dokumentave të paraqitura nga palët. Për rrjedhojë e drejta e paditësit për tu dëgjuar nga administrata tatimore është respektuar në rastin konkret. Në rastin konkret njoftim vlerësimi i DRT Korçë nuk përmbush asnjë nga kriteret e nenit 116 të K.Pr. Administrative në mënyrë që të konstatohet nga gjykata si një akt absoutisht i pavlefshëm.

Gjykata Administartive e Apelit vlerëson se njoftim vlerësimit tatimor nr. 22273 Prot datë 05.12.2014 është një akt administrativ i nxjerrë nga organi i përcaktuar me ligj, brenda kompetencave të dhëna nga ligji dhe në përputhje me formë dhe procedurën ligjore.

Në rrethanat si më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon se padia e ngritur nga pala paditëse është e pabazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e saj.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", vlerëson se vendimi nr. 459, datë 25.09.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012
"Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 459, datë 25.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.
2. Shpenzimet gjyqësore nuk ka.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 10.12.2015

GJYQTAR
Rilinda SELIMI
d.v

GJYQTAR
Altina NASUFI
d.v

GJYQTAR
Kastriot SELITA
d.v

Vertetohet njësia me origjinalin